

VENDIM
Nr.338, datë 1.6.2004

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.675, DATË 20.12.2002 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PËRDORIMIN E FONDEVE BUXHETORE TË PLANIFIKUARA PËR MALLRAT, SHËRBIMET DHE NDËRTIMET”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5 të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shtetit për Koordinimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.675, datë 20.12.2002 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në kapitullin II “Regjistri i parashikimeve të prokurimeve publike”, të bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Në pikën 2.2 afati “...brenda datës 30 janar të çdo viti,...” zëvendësohet me “... brenda datës 15 shkurt të çdo viti,...”.

b) Në pikën 2.3 afati “... brenda datës 15 shkurt të çdo viti.” zëvendësohet me “... brenda muajit shkurt të çdo viti.”.

c) Pas pikës 2.3 shtohet pika 2.4 me këtë përmbajtje:

“2.4. Organet e qeverisjes vendore dërgojnë përmbledhjen e regjistrave të parashikimeve të prokurimeve publike në Agjencinë e Prokurimit Publik dhe në Drejtorinë e Thesarit dhe Buxhetit, në Ministrinë e Financave, pas miratimit të buxhetit nga këshillat e qeverisjes vendore.”.

2. Në kapitullin III “Prokurimi i mallrave, shërbimeve dhe ndërtimeve”, të bëhen këto ndryshime:

a) Pika 3.1 ndryshohet si më poshtë vijon:

“3.1. Çdo ent prokurues të përfundojë procedurat e prokurimit, për përmbushjen e nevojave vjetore për mallrat, shërbime dhe ndërtime, të planifikuara e të ndara për secilën prej tyre, brenda muajit korrik të çdo viti, duke përfshirë në këtë afat edhe lidhjen e kontratave përkatëse.

Përfshihen nga afati i përcaktuar më sipër fondet e buxhetit të pavarur të pushtetit vendor (grant i pakushtëzuar + të ardhurat e krijuara nga organet e pushtetit vendor), të ardhurat që krijojnë institucionet buxhetore dhe që destinohen për t’u përdorur prej tyre brenda limiteve të përcaktuara nga ligji i Buxhetit të Shtetit, si dhe prokurimet me vlerë të vogël.”.

b) Në fund të pikës 3.2 shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

“Procedurat e prokurimit për këto fonde (të krijuara ose të shtuara) të përfundojnë brenda muajit tetor, duke përfshirë në këtë afat edhe lidhjen e kontratave përkatëse.”.

3. Në pikën 4.2 të kapitullit IV “Lidhja e kontratave”, pas fjalës “Kontratat...” shtohen fjalët “... lejohen të...”.

4. Në pikën 5.3 të kapitullit V “Regjistri i realizimit të prokurimeve”, afati “...brenda datës 31 korrik...” zëvendësohet me “... brenda datës 31 gusht...”.

5. Pragrafët I dhe VI të pikës 6.2, kapitulli VI “Të veçanta”, shfuqizohen.

6. Pas pikës 6.2 të kapitullit VI “Të veçanta” shtohet pika 6.2/1, me këtë përmbajtje:

“6.2/1. Për fondet, të cilat do të prokurohen nga institucionet e përcaktuara në pikën 6.2, entet prokuresuese të dërgojnë, brenda datës 20 shkurt, të dhënat teknike dhe sasiore pranë këtyre institucioneve. Institucionet pas përpunimit të të dhënave të shpallin, brenda datës 15 mars, ftesën për ofertë.”.

7. Pika 7.1 e kapitullit VII “Të fundit” ndryshohet si më poshtë vijon:

“7.1. Për vitin 2004, afati i përcaktimit në pikën 3.1 shtyhet deri më 15 gusht, duke përfshirë në këtë afat edhe lidhjen e kontratave përkatëse, ndërsa afati i përcaktuar në pikën 5.3 të kapitullit V “Regjistri i realizimit të prokurimeve”, shtyhet deri më 15 tetor.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

